



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 160 prot.

Tiranë, më 21. 01. 2025

V E N D I M

Nr. 19, datë 21. 01. 2025

Bazuar në ligjin Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O N:

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar ankesën nr. 222, datë 19.10.2023, të N. Sh., si përfaqësuese ligjore e vajzës së saj minorene, A. Sh.², kundër Bashkisë Korçë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike³”. Me vendimin nr. 81, datë 28.03.2024, Komisioneri ka disponuar në lidhje me çështjen, duke vendosur:

1. Konstatimin e diskriminimit të nxënësës A. Sh.⁴, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Korçë, si fëmijë e një familjeje që trajtohet me ndihmë ekonomike.
2. Bashkia Korçë të marrë masa efektive, për trajtimin me bursë, për vitin shkollor 2023-2024, të nxënësës A. Sh., bazuar në kriterin ekonomik, sipas pikës 2.1/c, të VKM nr. nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.
3. Me qëllim për të shmangur situata të tjera të ngjashme, si në rastin konkret, rekomandohet Bashkia Korçë, të marrë masa paraprake efektive, për rregullimin e situatave të tilla.

Rezulton e provuar nga lajmërim marrja nr. RR 594 469 880 AA, e shërbimit postar se, Bashkia Korçë ka marrë dijeni për vendimin në datën 03.04.2024.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Referuar Certifikatës familjare datë 19.09.2023, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë, vërtetohet se familja përbëhet nga 3 anëtarë, A. dhe N. Sh., janë prindër të fëmijës A. Sh.

³ Referuar Vërtetimit datë 21.09.2023 të lëshuar nga Bashkia Korçë, vërtetohet se A. Sh. trajtohet me ndihmë ekonomike me shumën 4792 lekë.

Referuar Vërtetimit datë 11.10.2023, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria Rajonale Korçë, vërtetohet se A. Sh. është i regjistruar si Punëkërkues i Papunë pranë Zyrës Vendore të Punësimit ZV AKPA Korçë. Referuar Vërtetimit datë 13.10.2023, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria Rajonale Korçë, vërtetohet se N. Sh. është e regjistruar si Punëkërkuese e Papunë pranë Zyrës Vendore të Punësimit ZV AKPA Korçë.

⁴ Përfaqësuar nga nëna, N. Sh.

Bazuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), përcaktohet se : “11. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.”

Në zbatim të nenit 33, pika 11, të LMD, Bashkia Korçë me shkresën⁵ nr. 222 prot., datë 17.04.2024, mbajti të njëjtin qëndrim me atë që kishte parashtruar gjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë, por nuk raportoi, në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Gjatë vitit 2023 dhe 2024, pranë Komisionerit janë trajtuar edhe 31 (tridhjetë e një) ankesa të tjera me të njëjtin objekt me çështjen në fjalë, paraqitur nga subjekte ankues të ndryshëm kundër Bashkisë Korçë. Në përfundim të shqyrtimit të tyre, Komisioneri ka mbajtur të njëjtin qëndrim duke konstatuar diskriminimin e subjekteve ankues nga ana e Bashkisë Korçë. Për një pjesë të tyre, Bashkia Korçë, iu drejtua me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuqizimin e tyre.

Në vijim, Komisioneri me shkresën nr. 510/2 prot., datë 30.12.2024, iu drejtua Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar informacion nëse pranë saj është regjistruar ankim për kundërshtimin e vendimit nr. 81, datë 28.03.2024 të tij. Përmes shkresës Nr. 21206/1 prot., datë 30.12.2024, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, informoi Komisionerin se nuk rezultonte të ishte paraqitur kërkesë padi sa i përket objektit të kërkesës sipërcituar.

Sa më sipër, rezultoi e provuar se, Bashkia Korçë, në cilësinë e subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, nuk ka marrë masa për zbatimin e vendimit nr. 81, datë 28.03.2024, të Komisionerit. Në këtë mënyrë, Bashkia Korçë, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 33, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33, pika 13, të ligjit të sipërpërmendur, shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Bashkia Korçë, ky nen përcakton shkrehimisht: “Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”:..... b) personi juridik nga **60.000 deri në 600.000 lekë**;.....”

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Bashkia Korçë është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, shkelje e cila sipas nenit 33, pika 13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë.

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 43 prot., datë 08.01.2025.

Në lidhje me masën e gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku sanksionohet se: “12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës dhe bazuar në, faktin që, referuar çështjeve të trajtuara, shkelja e konstatuar prek të paktën edhe 31 subjekte ankues të tjerë, Komisioneri, arrin në përfundimin se, Bashkia Korçë, duhet të gjobitet me 100 000 (njëqind mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr. 81, datë 28.03.2024.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “ç”, nenin 33, pika 11, 12 dhe 13, gërma “b”, si dhe nenin 33/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Bashkia Korçë⁶, të gjobitet në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr. 81, datë 28.03.2024, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Gjoka të paguhet në Buxhetin e Shtetit brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijani.
3. Pagesa e gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i vendimit nr. 81, datë 28.03.2024, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁶ Me NIPT: K54105075C